



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË

2021

RAPORTI I TREGUESVE FISKALË VENDOR

JANAR – SHTATOR

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e projektit 'Financat Lokale' nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO

FINANCATLOKALE | Forcimi i Menaxhimit
LOCALFINANCES | të Financave Publike
të Qeverisjes Vendore



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO

Përmbajtja

1.	Përmbledhje e gjetjeve kryesore.....	4
2.	Statusi Fiskal i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në fund të muajit shtator 2021	9
2.1	Të dhëna për të Ardhurat Vendore.....	10
2.2	Të dhëna për Shpenzimet Vendore.....	13
3.	Paraqitja grafike e treguesve në nivel bashkie.....	18



1. Përmbledhje e gjetjeve kryesore


Raporti i konsoliduar për performancën e Financave Vendore gjatë periudhës 9-mujore (Janar-Shtator 2021) është përgatitur nga Drejtoria e Financave Vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me mbështetjen e ekipit të projektit “Financat Lokale”, mbi bazën e të dhënave të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) dhe treguesit fiskalë të publikuar. Në këtë raport paraqitet ecuria e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimi i shpenzimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore në nivel Bashkie dhe Këshillë Qarku.

Në mbështetje të parashikimeve fillesatare dhe të rishikuara, viti 2021 shënon periudhën e rimëkëmbjes së ekonomisë në tersi dhe kjo reflektohet gjithashtu në treguesit fiskalë vendore pas presionit të fortë që ushtroi kriza e COVID-19 dhe përpjekjeve për përballimin e situatës. Këtë konstatim e reflekton plotësisht performanca pozitive e treguesve fiskal të pushtetit vendor, të cilat paraqiten në rritje jo vetëm krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë por edhe me të njëjtën periudhë të vitit para pandemisë.

Të ardhurat e veta të pushtetit vendor përbëjnë 6% të totalit të të ardhurave publike në 9 mujorin e vitit 2021, **me një realizim prej 23.1 miliard lekë**. Nga këto, 91% ose 21 miliard e zënë taksat dhe tarifatat vendore të cilat krahasuar me planin vjetor janë realizuar në masën 83%, dhe 2 miliard lekë të ardhurat jo tatimore. Të ardhurat vendore paraqiten me performancë në rritje, jo vetëm krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 vit ky i afektuar nga pandemia COVID-19 (27% më shumë ose ndryshe rreth 4.8 miliard lekë më shumë), por **ato paraqiten me rritje edhe në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019**.

Shpenzimet e pushtetit vendor gjatë 9 mujorit të vitit 2021 janë rreth **36.5 miliard lekë** ose rreth 63% të planit vjetor të miratuar, duke **zënë rreth 9% të totalit të shpenzimeve publike të qeverisjes së përgjithshme**. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shpenzimet e pushtetit vendor janë rritur me rreth **1%**.

Grafiku 1: Ecuria e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat të arkëtuara nga NJVQV-të dhe shpenzimeve vendore në raport me planin vjetor.



Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Heqja e kufizimeve të vendosura për shkak të pandemisë, është shoqëruar me riaktivizimit të ekonomisë e cila reflektohet në preferencën e treguesve të cilët paraqiten të përmirësuar krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Të ardhurat e veta të pushtetit vendor paraqiten me rritje me 27%, nga të cilat të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore me rritje me rreth 26% si dhe të ardhurat jo tatimore me rritje me rreth 33%.

Nga analiza e treguesve në tërësi vihet re që rritja kryesore e të ardhurave vjen nga grupi i **taksave të tjera lokale të cilat paraqiten me rritje me rreth 27% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, taksave të pasurisë me rritje rreth 26% kundrejt 9 muorit 2020 dhe 18% më shumë kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2019.**

Taksa e biznesit të vogël paraqitet me rënie me 2% krahasuar me 9 muorin 2020 për arsye të ndryshimeve ligjore që u bënë nga qeveria në lidhje me këtë taksë për ti hyrë në ndihmë biznesit. **Pesha e këtij zëri në raport me të ardhurat e tjera është e vogël vetëm 2%, si rrjedhim edhe efekti me ulje i kësaj takse ndaj totale të pushtetit vendor është i vogël.**

- **Bashkia Tiranës ka arkëtuar rreth 59% të totali të ardhurave vendore** (ose 13.5 miliard lekë) gjatë 9 muorit 2021. Ndërkohë që për bashkinë Tiranë burimi me të ardhurat më të mëdha është “Taksa e ndikimit në infrastrukturë” e cila


arrin vlerën e **5.8 miliard lekë**. Taksa e ndikimit në infrastrukturë e bashkisë Tiranë përbën **43%** të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë Tiranë, ose rreth **25%** të totalit të të ardhurave vendore për 61 bashkitë.

- Të grupuara sipas numrit të popullsisë, **bashkitë me mbi 100 mijë banorë (11 bashki përfshi edhe Tiranën)** kanë **realizuar 81% të totalit** të të ardhurave të veta të mbledhura nga 61 bashkitë në rang vendi si dhe **82% të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat** vendore të bashkive në rang vendi.
- Duke përjashtuar Bashkinë Tiranë, 10 bashkitë me **mbi 100 mijë banorë** kanë mbledhur rreth **5.1 miliard lekë ose rreth 54%** të totalit të të ardhurave vendore (për 60 bashkitë e mbetura).
- 13 bashkitë me popullësi **ndërmjet 50 -100 mijë banorë** kanë mbledhur rreth **1.7 miliard lekë ose rreth 19%** të totalit të të ardhurave vendore (të 60 bashkive pa përfshirë Tiranën).
- 37 bashkitë me popullsi **nën 50 mijë banorë** kanë mbledhur **2.6 miliard lekë ose 27.3%** të totalit të të ardhurave të veta vendore (të 60 bashki pa përfshirë Tiranën).

Nga pikëpamja strukturore, **3 lloje të taksave & tarifave vendore sigurojnë 84% të të ardhurave të mbledhura nga NJVQV-të (pa përfshirë të ardhurat jo tatimore) pra të vlerës 21,093 milion lekë**, duke përbërë burimin kryesor të financimit të politikave në nivel vendor “Taksa e ndikimit në infrastrukturë” me 34%, “Taksa mbi ndërtesat” me 18% dhe “Tarifa pastrimi e higjienë” me 16% apo zëri “Taksa të tjera” me 15%.

Referuar zërave specifik, me rritjen më të madhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë **rezulton “Taksa e fjetjes në hotel” me rritje me rreth 84%**. Kjo konfirmon edhe njëherë që viti 2021 ka qenë viti i rimëkëmbjes ekonomike edhe për shkak të heqjes së kufizimeve të cilat patën impakt të drejtpërdrejt në hapja e bizneseve. Rritja e numrit të turistëve këtë vit është shoqëruar më rritjen e të ardhurave të mbledhura nga pushteti vendor nga kjo taksë ku rezulton se, qytetet që kanë pasur të ardhurat me rritje nga kjo taksë janë Tiranë, Elbasan, Shkodër, Korçë, Durrës, Kavajë, Lezhë, Vlorë, dhe Sarandë.


Grafiku 2: Struktura në % të të ardhurave vendore sipas burimit në 9 mujorin 2021.



Burimi: Të ardhurat vendore sipas SIFQ, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Nëse në analizë do të marrim peshën e secilit funksion ndaj totalit të shpenzimeve për secilin vit, kjo strukturë është pak a shumë e ngjashme me të njëjtën periudhë të vitit 2020. Ndërkohe po ti referohemi vlerave faktike të 9 mujorit 2021 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, konstatohet një rialokim i fondeve nga funksionet “Rendi dhe Siguria Publike”, “Çështjet Ekonomike”, “Mbrojtja e Mjedisit”, “Shëndetësia” tek funksionet e tjera të pushtetit vendor.

Grafiku 3: Paraqet peshën specifike të shpenzimeve vendore sipas funksioneve në 9 mujorin 2021 kundrejt 2020.



Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Shpenzimet për investime kanë pësuar një rënie të lehtë prej 8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa investimet e **Bashkisë Tiranë përbëjnë rreth 30% të totalit të investimeve të realizuara nga pushteti vendor gjatë kësaj periudhe.**

Zëri të tjera ka pësuar një rënie të konsiderueshme në 9 mujorin e parë të vitit 2021 prej 35% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kjo për shkak se në vitin 2020 në këtë zë janë realizuar transfertat tek individët për ti ardhur në ndihmë si pasojë e pandemisë COVID-19.

2. Statusi Fiskal i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në 9 mujorin 2021

në milion lekë

Nr	EMERTIMI	9M 2021	9M 2020	Struktura e % të Ardhurave dhe Shpenzimeve 2021	Ndryshimi kundrejt 2020	Plani vjetor 2021 ¹	% Realizimit
A	TE ARDHURAT VENDORE	42,890	37,449	100%	15%	59,581	72%
I	Të ardhura të veta	23,135	18,282	54%	27%	32,500	71%
I.1	<i>Taksa dhe tarifa të mbledhura në nivel vendor</i>	21,093	16,745	49%	26%	25,426	83%
	a. Taksa mbi pasurinë	4,929	3,911	11%	26%	5,648	87%
	b. Biznesi i vogël	353	362	1%	-2%	0	
	c. Taksa dhe tarifa lokale të tjera	15,811	12,472	37%	27%	19,778	80%
I.2	<i>Të ardhura jotatimore</i>	2,042	1,537	5%	33%	2,688	76%
II	Të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar dhe sektoriale	19,463	18,989	45%	2%	26,514	73%
III	Grande	292	178	1%	64%	567	51%
B	SHPENZIMET VENDORE	36,548	36,338	100%	1%	57,841	63%
I	Shpenzimet për paga dhe sigurime	17,911	16,738	49%	7%	26,747	67%
II	Shpenzime operative	10,269	10,006	28%	3%	13,199	78%
III	Subvencione financiare	1,036	1,592	3%	-35%	3,415	30%
IV	Shpenzime kapitale	7,332	8,002	20%	-8%	14,480	51%
C	SUFICITI VENDOR	6,342	1,112	17%	471%	1,740	364%


Burimi: Tregusit fiskale të konsoliduar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

1. Të dhënat e planit vjetor 2021 i referohen Aktit Normativ Nr. 26, datë 22.6.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar".

2.1 Të dhëna për të Ardhurat Vendore

Të ardhurat e veta të pushtetit vendor në 9 mujorin e vitit 2021, janë realizuar rreth **23.1 miliard lekë** ku 91% ose 21 miliard e zënë taksat dhe tarifat vendore (**83% e planit vjetor 2021**), ndërsa 2 miliard lekë ose 9% të ardhurat jo tatimore. Krahësuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, të ardhurat e veta vendore janë realizuar me rreth **27%** më shumë ose në vlerë absolute **4.8 miliard lekë, nga të cilat të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore** janë realizuar me rreth **26%** më shumë ose në vlerë absolute **4.3 miliard lekë**.


Grafiku 4: paraqet raportin e të ardhurave në taksa dhe tarifa vendore gjatë 9M- 2021/2020.



Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Ndryshe nga 9 mujori i vitit të kaluar ku efekti i COVID-19 është ndjerë në treguesit e të ardhurave të veta vendore të cilat patën ulje krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, në 9 mujorin e vitit 2021 vihet re **një përmirësim i performancës së të ardhurave të veta** ku grupi i “taksa lokale të tjera” paraqiten me rritje me rreth 27% ose në vlerë absolute rreth 3 miliard lekë më shumë, më pas vjen grupi i “**Taksa të pasurisë**” me rritje me rreth **26%** ose ndryshe me një realizim në vlerë absolute rreth **1 miliard lekë** më shumë. Ndërsa zëri i biznesit të vogël paraqitet me ulje me 2% për shkak të efekteve të ndryshimeve ligjore të ndërmarra nga ana e qeverisë për ti hyrë në ndihmë biznesit. Por duke qenë se ky zë ka një peshë të vogël ndaj të ardhurat totale të pushtetit vendor rreth 2% edhe ndikimi është i vogël.

Grafiku 5: Të ardhura nga taksat e pasurisë në 9 mujin - 2021/2020




Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

- Gjatë 9 mujorit të vitit 2021, siç edhe është parashikuar në planin e përcaktuar, zëri që paraqitet me ulje është **taksa mbi biznesin e vogël me rreth 2%** ose ndryshe rreth **9 milion lekë** me pak se një vit më parë, **si pasojë e ndryshimeve ligjore**.
- Nga taksat mbi pasurinë** në 9 mujin e vitit 2021, janë akumuluar gjithsej **4.9 miliard lekë** ose rreth **1 miliard lekë më shumë** se e njëjta periudhë e një viti më parë. Peshën më të madhe e ka zëri i **taksës mbi ndërtesën** me një realizim rreth **3.7 miliard lekë ose 77%** të totalit të të ardhurave nga taksat mbi pasurinë.
- Në raport me totalin e të ardhurave nga taksat e pasurisë, gjatë 9 mujorit të vitit 2021, zëri i taksës së transaksioneve të pasurive të paluajtshme të realizuar në masën **504 milion lekë zë rreth 10% të totalit të taksës së pasurisë**, ndërsa zëri i taksës mbi **tokën bujqësore është realizuar në vlerën e rreth 418 milion lekë dhe zë 8%** të totalit të taksës së pasurisë. Zëri i **taksës së truallit** realizuar me rreth **215 milion lekë** është edhe zëri që ka peshën më të vogël në taksën e pasurisë rreth 4%.
- Gjatë 9 mujorit të vitit 2021, në totalin e grupit **“taksa lokale të tjera”** të vetëqeverisjes vendore si burimet më të rëndësishme paraqiten **“Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, e cila me 7.2 miliard lekë zë 46% të vlerës totale të grupit “taksave të tjera lokale” (prej 15.8 miliard lekë)**. Nga ky burim i të ardhurave vendore krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, janë akumuluar rreth **1.1 miliard lekë më shumë të ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore**.

Zëri tjetër më i rëndësishëm në këtë grup është dhe **“Tarifa e pastrimit dhe higjienës”** i cili zë **22% të totalit të këtij grupi të ardhurash, dhe ose ndryshe një realizim rreth 3.4 miliard lekë.**

- **Bashkia Tiranës ka mbledhur rreth 59% të totali të të ardhurave vendore** ose 13.5 miliard lekë gjatë 9 mujorit 2021. Ndërkohë që për bashkinë Tiranë burimi me të ardhurat më të mëdha është **“Taksa e ndikimit në infrastrukturë”** e cila arrin vlerën e **5.8 miliard lekë.** Taksa e ndikimit në infrastrukturë e bashkisë Tiranë përbën **43% të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë Tiranë**, ose rreth **25% të totalit të të ardhurave vendore** për 61 bashkitë.
- Të grupuara sipas numrit të popullsisë, **bashkitë me mbi 100 mijë banorë** (11 bashki përfshi edhe Tiranën) kanë **realizuar 81% të totalit** të të ardhurave të veta të mbledhura nga 61 bashkitë në rang vendi si dhe 82% të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të bashkive në rang vendi.
- Duke përjashtuar Bashkinë Tiranë, **10 bashkitë me mbi 100 mijë banorë** kanë mbledhur rreth **5.1 miliard lekë ose rreth 54% të totalit të të ardhurave vendore** (për 60 bashkitë e mbetura).
- **13 bashkitë me popullësi ndërmjet 50 - 100 mijë banorë** kanë mbledhur rreth 1.7 miliard lekë **ose rreth 19% të totalit** të të ardhurave vendore (të 60 bashkive pa përfshirë Tiranën).
- 37 bashkitë me popullsi **nën 50 mijë banorë** kanë mbledhur **2.6 miliard lekë ose 27.3% të totalit të të ardhurave të veta vendore** (të 60 bashki pa përfshirë Tiranën).

Grafiku 6: Të ardhura nga taksat lokale në 9 mujin 2021/2020




Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

2.2 Të dhëna për Shpenzimet Vendore

- **Totali i shpenzimeve të pushtetit vendor** gjatë 9 mujorit të parë të vitit 2021, është rreth **36.5 miliard lekë** ose rreth **63%** të planit vjetor të miratuar. Krahësuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shpenzimet e pushtetit vendor janë realizuar rreth **1% më shumë** ose në vlerë absolute rreth **211 milion lekë** më shumë.
- Në shpenzimet e realizuara 9 mujorin e vitit 2021, peshën më të madhe e zënë **shpenzimet e personelit me rreth 49%** e totalit të shpenzimeve vendore, pas tyre vijnë **shpenzimet operative me rreth 28%**; **shpenzime të tjera për subvencione dhe transferta me rreth 3%**, ndërsa shpenzimet për investime zënë rreth 20%.

Grafiku 7: Struktura e shpenzimeve vendore sipas natyrës ekonomike 9 mujori 2021/2020.




Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

- **Shpenzimet për investime kanë pësuar një ulje të lehtë me rreth 679 milionë lekë ose ndryshe rreth 8%** krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.
- **Bashkia e Tiranës zë rreth 30%** të totalit të investimeve të realizuara nga pushteti vendor gjatë kësaj periudhe.
- **Shpenzimeve të tjera korrente** (ku përfshihen edhe transfertat familjare, subvencionet) kanë **pasur një rënie** gjatë 9 mujorit të vitit 2021 rreth 556 milionë lekë ose ndryshe me rreth 35% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më

parë. Kjo për arsye se në të njëjtën periudhë vitin e kaluar për shkak të pandemisë u rritën transfertat tek individët.

- Referuar burimit të financimit të pushtetit vendor, edhe gjatë 9 muajve të vitit 2021 ashtu si në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar **peshën më të madhe e zënë shpenzimet e realizuara nga transfertat nga buxheti i shtetit me rreth 53%**, ndërsa ato nga **të ardhurat e veta zënë rreth 46%**, **1% shpenzimet me burim financimin e huaj dhe 0.3% shpenzimet e realizuara me burim financimi të ardhurat jashtë limitit.**
- Referuar vlerave reale për secilin burim, financimi nga buxheti i shtetit është rrit me 2.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, financimi i huaj me 64%, ndërsa financimi nëpërmjet të ardhurave të veta është ulë me 1%, si dhe nëpërmjet të ardhurat jashtë limitit me ulje me 71%.

Grafiku 8: Prezanton strukturën e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas burimit të financimit për 9M 2021/2020.




Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

- Për Bashkinë Tiranë, 21% e shpenzimeve janë financuar nga transfertat e buxhetit qendror dhe 77% nga të ardhurat e veta**, si dhe 1% financim i huaj dhe 0.3 te ardhurat jashtë limitit.
- Në 9 muajin e vitit 2021, konstatohet rritje të shpenzimeve në funksionet si “Shërbimet e përgjithshme publike”, “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit”, “Arsimi”, “Argëtimi kultura dhe feja”, dhe “Mbrojtja sociale” në vlerën totale prej **rreth 1 miliard lekë** më shumë se një vit më parë.

- Në 9 mujorin e vitit 2021 gjithashtu konstatohet se ulje ka në funksionet “Rendi dhe siguria publike”, “Çështjet ekonomike”, “Mbrotjtja e mjedisit” dhe “Shëndetësia” me rreth 842 milion lekë të cilat janë alokuar tek programet që paraqiten me rritje.
- Funksioni i “Mbrotjtjes së mjedisit” në 9 mujorin e vitit 2021 paraqitet me ulje me 1% ose ndryshe rreth 42 milion lekë më pak se e njëjta periudhë e viti të kaluar. Kjo ulje nuk është në vlera të larta por nisur nga pesha e vogël që ka ky funksion ndaj shpenzimeve totale të pushtetit vendor rreth 8%, si edhe nga situata e krijuar me menaxhimin e mbetjeve në disa bashki bregdetare dhe jo vetëm, neqet për tu adresuar se në të ardhmen.**

Grafiku 9: Pesha e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas funksioneve në 6 mujorin 2021/2020.




Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

- Funksioni “Shërbimet e përgjithshme publike” ka rritjen më të madhe të shpenzimeve** gjatë 9 mujorit të vitit 2021, krahasuar me një vit më parë me rreth **711 milion lekë ose 8% më shumë**, dhe më pas vjen “Argëtimi kultura dhe feja” me rritje me rreth 5%.
- Krahasuar më të njëjtën periudhë të një viti më parë **funksionet që paraqiten me uljen më të madhe** janë “Shëndetësia” me rënie me rreth 20% si dhe “Çështjet ekonomike” me rreth 10%.
- Bashkia Tiranë, në 9 mujorin e vitit 2021 ka realizuar rreth **29% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor me një vlerë 10.4 miliard lekë**, ndërkohë që shpenzimet për investime të kësaj bashkie **zënë 30%** të totalit të investimeve të realizuara nga pushteti vendor gjatë kësaj periudhe.

- Të grupuara sipas popullsisë në 9 mujorin e vitit 2021, duke përfshirë Bashkinë Tiranë, **10 bashkitë me mbi 100 mijë banorë** kanë realizuar rreth **11 miliard lekë shpenzime ose 43%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor (60 bashki pa Tiranën),
- 13 bashkitë me një popullsi **ndërmjet 50 -100 mijë banorë** kanë realizuar rreth **5.8 miliard lekë shpenzime ose 23%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor (60 bashki, pa Tiranën)
- Pjesa tjetër prej 37 bashkive që kanë popullsi **nën 50 mijë banorë** kanë realizuar **rreth 8.6 miliard lekë shpenzime ose ndryshe 34%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor.


Grafiku 10: Shpenzimet vendore sipas funksioneve dhe burimeve të financimit në 9 mujorin 2021



Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021);

Referuar grafikut të mësipërm konstatohet se pushteti vendor për funksione të caktuara si “Shërbimet e përgjithshme Publike” dhe “Arsimi” përdorin transfertat e buxhetit qendror për financimin në pjesë të konsiderueshme ushtrimin e aktivitetit. Ndërkohë për funksione të caktuara si “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit” apo “Çështjet Ekonomike” peshën më të madhe të financimit të këtyre funksioneve e zënë të ardhurat e vetë njësitë të vetëqeverisjes vendore.


Grafiku 11: Krahاسimi në pikë përqindje ndërmjet 9 mujorit 2021/2020 lidhur me shpenzimet sipas funksioneve vendore dhe burimeve të financimit.



Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)


3. Paraqitja grafike e treguesve në nivel bashkie

Grafiku 12: Përqindja e të ardhurave sipas bashkive ndaj totalit të ardhurave vendore 9 muji 2021.




Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 13: Pesha e të ardhurave të secilës bashki ndaj totalit të të ardhurave vendore pa bashkinë Tiranë për 9 mujorin 2021.




Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 14: Ndryshimi i të ardhurave vendore sipas bashkive në 9 mujorin 2021/2020.




Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 15: Përqindja e shpenzimeve sipas bashkive ndaj totalit të shpenzimeve vendore, 9 muji 2021.




Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 16: Pesha e shpenzimeve të secilës bashki ndaj totalit të shpenzimeve vendore pa bashkinë Tiranë për 9 mujorin 2021



Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

Grafiku 17: Ndryshimi i shpenzimeve vendore sipas bashkive në 9 mujorin 2021/2020.



Burimi: Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2021)

